

Trajtimi i ngacmimit seksual në Universitetet Publike

Nga: MSc. Ariana Qosaj-Mustafa për Artpolis

Me kontribut të: Jetbardha Selmani dhe Jeta Berisha

Trajtimi i ngacmimit seksual në Universitetet Publike

**Nga MSc. Ariana Qosaj-Mustafa për Artpolis
Me kontribut të: Jetbardha Selmani dhe Jeta Berisha**

Prishtinë

Shkurt 2017

© Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis. 2017.

Ky raport është përpiluar nga Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis, është financuar përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	4
2. Përhapja e rasteve të ngacmimit seksual në Kosovë / reagimi ekzistues brenda universiteteve publike	5
3. Ligji i zbatueshëm në Kosovë për ngacmimet seksuale	8
4. Rregullorja e Universitetit Publik të Prishtinës për rastet e ngacmimit seksual.....	16
5. Rekomandimet.....	20
6. Referencat.....	23

Shtojca: Përmbajtja e projektligjit për ngacmimet seksuale

1. Hyrje

Raporti trajton rastet e ngacmimit seksual në universitetet publike të Kosovës duke u fokusuar në Universitetin e Prishtinës, si universiteti më i madh publik. Qëllimi i tij i përgjithshëm është për të analizuar trendet ekzistuese në trajtimin e ngacmimit seksual në Universitetin e Prishtinës duke analizuar gjithashtu reagimin ekzistues dhe propozimin e një sërë rekomandimeve për të përmirësuar trajtimin ekzistues të rasteve në kuadër të universiteteve publike të Kosovës. Raporti gjithashtu ka për qëllim të ofrojë rekomandime konkrete në zhvillimin e mekanizmave të përshtatshëm për rritjen e raportimit dhe trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual.

Hulumtimi dhe analiza e raportit ka filluar në shtator të vitit 2016 dhe ka përfunduar në janar të vitit 2017. Janë realizuar një numër i intervistave me pyetësorë gjysëm të strukturuar me studentë nga Universiteti i Prishtinës, personelin arsimor, si dhe me përfaqësues institucional¹. Artpolis ka organizuar edhe një sërë panele dhe sesione informuese me studentët në Prishtinë, Gjakovë, Prizren dhe Mitrovicë për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe për t'ju shpjeguar dispozitat ligjore ekzistuese si dhe për t'ju dhënë informacion mbi ligjet dhe procedurat për studentët të cilëve ju mungojnë njohuritë e mjaftueshme për rregullat dhe rregulloret ekzistuese në kuadër të universiteteve publike të Kosovës për raportimin e rasteve të mundshme të ngacmimit seksual. Panelet kanë ofruar informata për tendencat ekzistuese në kuadër të universiteteve për shpërndarjen e informacionit mbi procedurat ekzistuese brenda universiteteve, përgjigjen e ligjit në fuqi për trajtimin e rasteve të ngacmimeve seksuale, si dhe informata për studentët se si të identifikojnë, të vërejnë dhe të raportojnë rastet e ngacmimit seksual. Qëllimi i paneleve ka qenë për të kërkuar informata nga studentët se si universitetet publike të financuara nga paratë e taksapaguesve të Kosovës u janë përgjigjur dhe i kanë trajtuar pretendimet e mundshme të raportimeve të ngacmimit seksual dhe çfarë qasje janë duke përdorur. Më shumë se 100 studentë kanë qenë pjesë e diskutimeve të hapura gjatë paneleve dhe ishin të gatshëm për të diskutuar lirishëm çështjet e ngacmimit seksual me të cilat përballen studentët në universitetet publike, diskutime që janë pasqyruar edhe në gjetjet e këtij raporti.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij raporti është që të përshkruaj përfshirjen e një mekanizmi funksional në universitetet publike për trajtimin e rasteve të ngacmimeve seksuale, në mënyrë që studentët të arrijnë njohuri, raportojnë rastet dhe të pajisen me mundësi për një arsimim të lirë dhe të barabartë si dhe trajtimin dinjitoz të garantuar në mënyrë specifike nga Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet. Raporti ka shqyrtuar mekanizmin ekzistues në dispozicion në vende të tjera me traditë të reagimit në mënyrë më efektive, duke iu përgjigjur në kohë dhe duke kompensuar kërkesat e

¹ Lista e plotë mund të gjendet te Artpolis.

viktimave të ngacmimit seksual. Qëllimi i mekanizmit të propozuar ishte për të mbështetur zhvillimin e një sistemi të përgjegjshëm në kuadër të universiteteve publike të Kosovës për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive çfarëdo raportimi potencial apo dukurie të rasteve të ngacmimit seksual. Raporti gjithashtu propozon një rregullore/politikë për universitetet publike të Kosovës për raportimin e rasteve të ngacmimit seksual, të paraqitur në pjesën e shtojcës së raportit.

2. Përhapja e rasteve të ngacmimit seksual në Kosovë: reagoni ekzistues brenda universiteteve publike

Në përgjithësi, rastet e ngacmimit seksual raportohen minimalisht në Kosovë, edhe pse prevalanca e personave që i janë nënshtruar ngacmimit seksual nuk është e ulët. Në raportin e publikuar së fundmi nga Rrjeti i Grave të Kosovës për rastet e ngacmimit seksual në Kosovë, vlerësohet se 48.5% e kosovarëve kanë përjetuar një formë të ngacmimit seksual. Në vitin 2014 45.2% e respondentëve kanë pretenduar se gjatë atij viti, ata kanë qenë të ekspozuar apo kanë përjetuar një formë të ngacmimit seksual. Nga ky numër 64.1% e rasteve kanë qenë gra që kanë raportuar një formë të ngacmimit seksual përkundër 32.5% të rasteve të burrave të raportuara². Personat e rinj kanë raportuar se kanë përjetuar ngacmim seksual më shumë se sa të moshuarit.

Si forma më të zakonshme të ngacmimit seksual raportohen komente të padëshirueshme seksuale, bërja shaka me kuptimin seksual apo gjeste seksuale sidomos kur ecin nëpër rrugë. Kryesisht ngacmimi ka ndodhur nga persona të panjohur, por ka pasur edhe raporte të ngacmimit nga të njohurit, bashkë-punëtorët, mësuesit dhe partnerët e tyre. Në këto raste viktimat dhe dëshmitarët kanë tendencë të injorojnë ngacmimet duke shpresuar që ajo të kalojë. Një numër minimal i personave raportojnë këto raste ngacmimi, vetëm 4.1% të të gjithë të anketuarve kanë raportuar ndonjëherë raste tek autoritetet ose kishin dijeni për dikë që ka raportuar rastin.³

Në njohjen e asaj që çfarë konsiston ngacmimi seksual një numër më i lartë i burrave të moshuar janë të vetëdijshëm për karakteristikat e tij në krahasim me gratë e moshuara. Gratë më të reja duket të kenë me pak njohuri se sa meshkujt e rinj rreth asaj që çfarë veprimesh përbëjnë rastet e ngacmimit seksual. Shumica e 69.3% e të intervistuarve identifikojnë veprat penale të dhunshme si forma të rasteve të ngacmimit seksual me dhunim ose tentativë përdhunimi që shihen si forma më karakteristike të ngacmimit seksual. Më pak se gjysma e të anketuarve (49%)

² Raporti i Rrjetit të Grave të Kosovës "Ngacmimi seksual në Kosovë," 2016, fq.8-10. Në dispozicion në <http://www.womensnetwork.org/documents/20160224112147815.pdf>

³ Raporti i Rrjetit të Grave të Kosovës "Ngacmimi seksual në Kosovë," 2016, fq.8-10. Në dispozicion në <http://www.womensnetwork.org/documents/20160224112147815.pdf>

mendojnë se presioni për favore seksuale, prekja, pickimi, ose shtyrja dhe fishkëllima e dikujt në rrugë (43.8%), mund të përkufizohen si forma të ngacmimit seksual.⁴

Në përgjithësi ka vetëdije dhe njohuri të ulët rreth asaj se çfarë saktësisht mund të përbëjnë veprimet e ngacmimit seksual si të tillë dhe kjo mund të krijojë sfida në identifikimin, raportimin dhe përdorimin e ligjeve ekzistuese⁵. Më shumë se 74% e të anketuarve deklaruan te Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës se viktimat duhet të fajësohen kur ndodh ngacmimi seksual në qoftë se gruaja është e veshur ose sillet në mënyrë provokuese⁶. Pak më shumë gra ishin të prirura që të pajtohen me këtë deklaratë se sa meshkujt me pothuajse një të tretën e kosovarëve që besojnë se njerëzit natyrisht ngacmojnë të tjerët, kur ata janë tërheqës për ta, më shumë meshkuj (35.4%) se femra (26.9%) pajtohen se sjellja është e pranueshme, me pothuajse 40% që pretendojnë se grave ju pëlqen të "ngacmohen."⁷

Me një kulturë që në përgjithësi ofron ndëshkim të ulët lidhur me aktet e ngacmimeve në rrugë dhe një qasje të përgjithshme për të fajësuar viktimat në qoftë se janë veshur "në mënyrë të papërshtatshme dhe provokative", Kosova mbetet shumë prapa në krijimin e një mjedisi të sigurtë për gratë e saj të reja dhe burrat që të trajtohen me dinjitet.

Raporti ka shqyrtuar më tej fenomenin e rasteve të ngacmimit seksual në kuadër të Universitetit publik të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mënyrë që të merret një pasqyrë e të kuptuarit të tanishëm të rasteve dhe niveleve të ndërgjegjësimit të mekanizmave ekzistues që të raportojnë rastet e mundshme të ngacmimit seksual.

Kosova aktualisht ka gjashtë universitete publike, me Universitetin e Prishtinës që është më i madhi e që ka të regjistruar pothuajse gjysmën e numrit të përgjithshëm të studentëve në kuadër të universiteteve publike⁸. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", gjatë 2015/2016 ka regjistruar 11.524 studentë të vitit të parë⁹. Nga ky numër 55% janë studentë aktiv të regjistruar si femra dhe 45% studentë aktiv si meshkuj¹⁰.

⁴ Ibid, fq. 8-10.

⁵ Ibid, fq. 8-10.

⁶ Ibid.

⁷ Supra note 3 në fq. 8-10.

⁸ Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina;" Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti;" Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani;" Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini;" Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka;" dhe Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka."

⁹ Statistikat zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, fq. 88. Në dispozicion në <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-shq.pdf>

¹⁰ Statistikat zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, fq. 88. Në dispozicion në <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-shq.pdf>

Institucionet e arsimit janë në përputhje me dispozitat e ligjeve të veçanta. Ekziston një grup i dispozitave ligjore që ofron mbrojtje të mjaftueshme për dinjitetin dhe sigurinë e studentëve parauniversitar dhe universitar në kuadër të sistemit arsimor të Kosovës. Së pari, Kushtetuta e Kosovës garanton dhe mbron dinjitetin e njeriut si të pacenueshëm dhe një bazë të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për qytetarët e saj¹¹. Së dyti, Ligji për Arsimin Parauniversitar, gjithashtu thekson se qasja në të gjitha nivelet e arsimit universitar dhe trajnimit duhet të sigurohet në përputhje me kërkesat e ligjit, pa asnjë diskriminim në bazë të gjinisë, racës, orientimit seksual, dhe paaftësisë fizike¹². Më tej, neni 4 i këtij ligji parashikon gjithashtu dispozita të veçanta për mbrojtjen e grupeve të cenueshme duke deklaruar se "Një person i punësuar në institucionet arsimore, siç është përcaktuar me këtë ligj duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që studentët dhe stafi nuk lëndohen apo ekspozohen ndaj fjalëve dhe veprimeve fyese."¹³

Për më tepër, në nivelin universitar, raportohet se ngacmimi seksual është i përhapur edhe pse raportimi i rasteve të ngacmimit seksual duket pothuajse nuk ekziston, në rastet kur janë bërë raporte, shumica e raporteve mbeten të patrajtuara¹⁴. Studentet femra të intervistuar nga Artpolis kanë pretenduar të jenë në dijeni të shfaqjes së rasteve të ngacmimit seksual, por ato nuk i raportojnë ato sepse nuk i besojnë institucionit. Ka pasur raste që studentët janë bindur të mos i çojnë rastet më tej për shkak të pasojave të mundshme dhe/ose turpit publik që i vihet studentit në rast të raportimit.¹⁵

Në përgjithësi, ka mungesë të të dhënave për shkallën e shfaqjes së fenomenit dhe nuk ka analiza ekzistuese ose sondazhe anonime të bëra me studentët e universiteteve publike për të kuptuar më tej shkallën e problemit. Edhe pse Kodet e Sjelljes ekzistojnë, nuk ka politika të hartuara në mënyrë specifike për të trajtuar rastet e ngacmimit seksual të njohura si politika për ngacmimin seksual. Universitetet publike në Kosovë kanë vetëm Kodet e Sjelljes, por nuk kanë politika specifike për ngacmimin seksual që ofrojnë përkufizimin se cilat forma përbëjnë ngacmimin seksual në përputhje me ligjin në fuqi, që shpjegojnë në detaje mekanizmat e

¹¹ Kushtetuta e Kosovës, Neni 23. Në dispozicion në http://www.gjks.org/repository/docs/Kushtetuta_RK_ang.pdf

¹² Republika e Kosovës, *Ligji i Arsimit Para Universitar në Republikën e Kosovës*, Kosovë, 2011, në: <http://www.erisee.org/sites/default/files/Law%20on%20Pre-University%20Education%20in%20the%20Republic%20of%20Kosovo%20No.04-L%20%E2%80%933032.pdf>.

¹³ Ibid, Neni 4.

¹⁴ Ibid.

¹⁵ Intervistat e Artpolis me studentët e Universitetit Publik të Prishtinës, Tetor-Dhjetor 2016.

raportimit, e bëjnë mekanizmin e tillë të njohur dhe e vënë në dispozicion për studentë, duke përcaktuar procedurat e ngacmimit seksual në përputhje me zhvendosjen e barrës së provës dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit kundër Diskriminimit¹⁶, si dhe përcaktojnë në detaje procedurat që duhet të ndiqen nga stafi akademik dhe administrativ, pasi rastet të raportohen dhe fillojnë procedurat e apelimit¹⁷. Artpolis nuk është njoftuar nëse ndonjë nga universitetet publike ka monitoruar apo vlerësuar nivelin e njohurive dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave në lidhje me Kodin e Sjelljes, duke përfshirë edhe rastet ekzistuese të ngacmimit seksual të studentëve të tyre.

Edhe pse universitetet publike janë institucionet më të mëdha arsimore që mbulohen nga paratë e taksapaguesve të Kosovës, deri tani atyre ju ka munguar përgjegjshmëria ndaj studentëve të tyre për t'ju shpjeguar detajisht dhe zbatuar kodet ekzistuese të etikës dhe as nuk kanë hartuar deri tani asnjë politikë specifike për ngacmim seksual.

3. Ligji i zbatueshëm në Kosovë për ngacmimet seksuale

Një bollëk i ligjeve trajton rastet e ngacmimit në Kosovë, duke përfshirë edhe rastet e ngacmimit seksual. Shumica e mbrojtjeve ligjore që ka të bëjë me rastet e ngacmimit seksual, definojnë nën procedurat e mbuluara nga ligjet civile.

Ligji i miratuar së fundmi i Kosovës për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlen për të gjithë personat, përfshirë personat juridik të të dy organeve publike dhe private, dhe reagon ndaj çdo veprimi apo mosveprimi i cili shkel të drejtat e atyre personave në qasje tek kushtet e punësimit, trajnimit profesional, promovimit apo qasjes në mallra dhe shërbime si dhe mbrojtjes sociale¹⁸. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi mëtej përcakton ngacmimin si një formë e diskriminimit të sjelljes së padëshiruar duke mos u kufizuar vetëm për sjelljen seksuale të padëshiruar, me qëllim ose efekt në shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimit të një ambienti frikësues, armiqësor, degradues, poshtëruës ose ofendues bazuar në seksin e personave, gjininë apo orientimin seksual dhe shkaqe të tjera të diskriminimit.¹⁹

Nga ana tjetër, ligji i zbatueshëm i Kosovës gjithashtu merr parasysh Konventën për të gjitha Format e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë dhe në

¹⁶ Në zhvendosjen e barrës së provës, shih analizat nën seksionin 3 të këtij raporti.

¹⁷ Shih draft rregulloren për ngacmimet seksuale, Shtojca e raportit.

¹⁸ Ligji Kundër Diskriminimit, Neni 2.

¹⁹ Arsytet e tjera të diskriminimit janë përcaktuar më tej në nenin 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Nr. 05/L-021. Në dispozicion në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-021%20a.pdf>

raste te konfliktit dispozitat e tij konsiderohen të kenë prioritet mbi dispozitat e ligjeve të brendshme dhe akteve të tjera të institucioneve publike²⁰. Protokollet dhe rekomandimet e CEDAW janë të zbatueshme në kornizën ligjore të Kosovës, me Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19 te CEDAW që përcakton ngacmimet seksuale ndaj grave specifikisht si forma te "sjelljes së përcaktuar të papëlqyer seksuale si kontakt fizik dhe favorizim, vërejtjet me ngjyrim seksual, të treguarit e pornografisë dhe kërkesa seksuale, qoftë me fjalë ose veprime."²¹ Më tej, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Kosovë (Ligji kundër diskriminimit) është në përputhje me një numër të Direktivave të BE-së që kanë të bëjnë me zbatimin e trajtimit të barabartë, duke përfshirë punësimin dhe profesionin; zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasje dhe në furnizim me mallra dhe shërbime; dhe është në përputhje me parimin e mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave që kanë të bëjnë me punësimin dhe profesionin²². Direktivat e BE-së vëjnë një theks në definimin e ngacmimit seksual, në mënyrë që të'ju ofrohen mundësi të barabarta grave dhe burrave në ushtrimin e të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë për punësim, profesion dhe në qasje dhe furnizimin me mallra dhe shërbime.

Për më tepër, përkufizimi i ngacmimit seksual i përshkruar në direktivat e BE-së i referohet rasteve kur "ndodh çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, jo-verbale apo fizike e një natyre seksuale, me qëllimin apo efektin e dhunimit të dinjitetit të një personi, në veçanti kur krijon një ambient kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes". Këto akte konsiderohen diskriminim në bazë të gjinisë brenda vendeve anëtare të BE-së të cilat inkurajohen në ndalimin e formave të tilla të diskriminimit.²³ Gjithashtu viktimizimi i mëtejshëm është i ndaluar nga Direktivat

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008. Në dispozicion në <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>.

²¹ UN CEDAW, Rekomandimet e përgjithshme Nr. 19 në Dhunën kundër Grave, Para. 9, në <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm>.

²² Shih Direktivën e Këshillit 2000/43 / EC e 29 qershorit 2000 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike të Këshillit të Bashkimit Evropian, Direktiva e Këshillit 2000/78 / EC të datës 27 nëntor 2000 për krijimin e një kornize të përgjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion e Këshillit të Bashkimit Evropian, Direktiva e Këshillit 2004/113 / EC të 13 dhjetorit 2004 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve e Këshillit të Bashkimit Evropian 2, Direktiva 2006/54 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave që kanë të bëjnë me punësim dhe profesion (i ndryshuar) i Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian. Në dispozicion në <http://eur-lex.europa.eu/>.

²³ Shih Direktivën Evropiane 2002/73 / EC për trajtimin e barabartë në punësim për gratë dhe burrat, të plotësuar nga Direktiva Evropiane 2006/54 / EC, 5 korrik 2006 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave në punë dhe profesion, në <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32002L0073>. Përveç kësaj, Direktiva Evropiane 2004 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në qasje në ofrimin e shërbimeve dhe përdorimin e mallrave përdorimin detajon më tej qasjen e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë në shërbime bazuar në parimin e mosdiskriminimit.

e BE-së dhe Ligjit të Kosovës Kundër Diskriminimit në rastet kur personi që raporton një kërkesë diskriminimi vuan nga efektet negative dhe/ose kur një procedurë e tillë inicohet ose kur personi mund të ofrojë dëshmi mbi shkeljen e parimit të trajtimit të barabartë në lidhje me procedurën e ankesës në rastet e diskriminimit.²⁴ Ligji i ri kundër diskriminimit gjithashtu ofron një risi duke parashikuar mundësinë që një grup individësh të paraqesin një padi në gjykatën kompetente të ligjit dhe jo vetëm të një individi, të drejtën që së bashku të deklarojnë rastet e diskriminimit të bazuar në fushën e diskriminimit që përcaktohet sipas nenit 1 të Ligjit²⁵. Këto baza të diskriminimit kanë të bëjnë me kombësinë, komunitetin, origjinën sociale, racën, etninë, ngjyrën, lindjen, origjinën, seksin, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, gjuhën, shtetësinë, fenë dhe besimin fetar, përkatësinë politike, mendimin politik ose tjetër, statusin social apo personal, moshën, gjendjen familjare ose martesore, shtatëzaninë, lindjen, pasurinë, statusin shëndetësor, paaftësinë, trashëgiminë gjenetike ose ndonjë arsye tjetër.²⁶

Është me rëndësi **parimi i zhvendosjes së barrës së provës**, i paraparë sipas ligjit kundër diskriminimit në përputhje me kërkesat e Direktivave të BE-së. Kjo dispozitë është gjithashtu një obligim për t'u zbatuar nga çdo organ administrativ, si dhe gjykata. Në bazë të nenit 20 të Ligjit Kundër Diskriminimit zhvendosja e barrës së provës duhet të përdoret në të gjitha rastet kur individët pretendojnë rastet e diskriminimit dhe pretendojnë shkeljen e së drejtës për trajtim të barabartë. Në këto raste personat paraqesin pretendimet e tyre për të mbrojtur të drejtat e tyre para organit administrativ ose gjykatës kompetente. Në këto raste barra e provës për pretendimet e diskriminimit do të shkojë tek i padituri (pala përgjegjëse), i cili duhet të vërtetojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë. Në këto raste personi i deklaruar se ka diskriminuar kundër viktimës (i padituri) duhet të ofrojë dëshmi se akti i diskriminimit nuk ka ndodhur me zhvendosjen e barrës së provës tek i padituri.²⁷

Zhvendosja e barrës së provës duhet të përdoret në procedurat civile sepse ajo shkon kundër parimit penal të supozimit të pafajësisë derisa të dëshmohet fajësia. Prandaj zhvendosja e barrës së provës në pretendimet e diskriminimit nuk mund të përdoret në raste kriminale e as të veprave penale.²⁸ Megjithatë, në të gjitha procedurat në nivele administrative dhe në gjykata që punojnë me procedurat civile është një rregull i përgjithshëm që aplikohet në përputhje me ligjin kundër diskriminimit. Përveç kësaj, ligji gjithashtu e kupton ndjeshmërinë e përgjigjies së shpejtë për rastet e diskriminimit, pasi që vonesat e paarsyeshme mund të shkaktojnë tërheqjen e

²⁴ Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, Neni 4, paragrafi 1.4.

²⁵ Ligji Kundër Diskriminimit, Neni 1 dhe Neni 13.

²⁶ Ligji Kundër Diskriminimit, Neni 1.

²⁷ Shiko Ligjin Kundër Diskriminimit, Neni 20, paragrafi 2.

²⁸ Ligji Kundër Diskriminimit, paragrafi 3.

pretendimeve për diskriminim nga viktimat, ose vonesa mund të përdoret për t'i bindur viktimat nga të akuzuarit ose persona të tjerë të përfshirë jo për të ndjekur më tej pretendimet e tyre, dhe për këtë arsye që të gjitha rastet e diskriminimit trajtohen me procedurë urgjente, sipas kërkesave të Ligjit mbi procedurën Kontestimore.²⁹ Gjatë intervistave, Artpolis nuk ka hasur në ndonjë rast ku procedura e zhvendosjes së barrës së provës ose përdorimi i procedurave urgjente janë përdorur nga ndonjë prej universiteteve publike. Në shumicën e rasteve studentët bien dakord se ekzistojnë raste të ngacmimit, megjithatë ka raportim minimal të rasteve të tilla. Në rastet kur pretendimet e ngacmimit janë raportuar apo diskutuar, ka pasur raste kur institucioni i ka shtyrë për pajtim dhe ka bind viktimën e mundshme që të mos ndjek çështjen më tej.³⁰

Ligji i ri Kundër Diskriminimit i miratuar në vitin 2015 parashikon gjithashtu gjoba që do të lëshohen për pretendimet e diskriminimit duke filluar nga 400 € deri në maksimum prej 1,350 €. ³¹ Gjohat janë kritikuar si jo adekuate dhe mbeten të ulëta si masa monetare sidomos kur merren parasysh pretendimet e ndjeshme të ngacmimit seksual që mund të ndodhin dhe pasojat për viktimat.³² Sipas Ligjit Kundër Diskriminimit edhe procedurat e pajtimit dhe ndërmjetësimit janë të parapara në qoftë se individët preferojnë të përdorin procedurat e tilla. ³³ Gjatë intervistave me studentët dhe panelet e diskutimit, Artpolis nuk ka hasur në ndonjë rast të raportuar të ngacmimit seksual ku gjykatat kanë lëshuar gjoba në përputhje me kërkesat e ligjit kundër diskriminimit.³⁴

Shkeljet e tjera të rasteve të diskriminimit, duke përfshirë procedurat penale, trajtohen në bazë të Kodit Penal të Kosovës. Veprat penale të Kosovës që trajtohen në kuadër të procedurës penale nuk janë të përcaktuara shprehimisht në Ligjin Kundër Diskriminimit. Ligji i referohet vetëm Kodit Penal për vepra të tilla në përgjithësi.³⁵ Kompensimi i dëmeve materiale ose jo-materiale është i paraparë edhe me Ligjin Kundër Diskriminimit me kthimin në gjendjen e mëparshme para se të ndodhë rasti i diskriminimit, masat duhet të urdhërohen nga gjykata civile. Megjithatë, niveli i kompensimit të dëmeve nuk specifikohet sipas Ligjit Kundër Diskriminimit.³⁶ Vetë ligji ofron mundësi të pakufizueshme për institucionet përgjegjëse, për të ndërmarrë një sërë masash dhe për të përcaktuar procedurat përbrenda për zbatimin e ligjit.³⁷ Prandaj, asnjë nga rregulloret e miratuara nga Universitetet Publike të Kosovës të monitoruara nga Artpolis, nuk kanë hartuar

²⁹ Ligji Kundër Diskriminimit, Neni. 16.

³⁰ Intervistat dhe panelet me studentë të Artpolis-it, Qershor-Dhjetor 2016.

³¹ Ligji Kundër Diskriminimit, Neni. 23.

³² Shikoni raportin e Rrjetit të Grave të Kosovës “Ngacmimi seksual në Kosovë,” 2016. Në dispozicion në <http://www.womensnetwork.org/documents/20160223185243349.pdf>

³³ Ligjit Kundër Diskriminimit

³⁴ Intervistat dhe panelet me studentë të Artpolis-it, Qershor-Dhjetor 2016

³⁵ Shikoni Nenin 17 të Ligjit Kundër Diskriminimit.

³⁶ Ligji Kundër Diskriminimit, Neni. 16.

³⁷ Neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit.

rregulloret e tyre lidhur me raportimin dhe adresimin e rasteve të ngacmimit seksual, në përputhje me kërkesat e Ligjit të sapo miratuar kundër diskriminimit³⁸. Më tej, këto rregullore dështojnë të përmendin procedurat e parapara për pretendimet e diskriminimit, duke përfshirë zhvendosjen e barrës së provës në rastet e ngacmimit seksual, siç parashihet nga ligji i ri kundër diskriminimit i miratuar në qershor të vitit 2015 apo edhe ligjit të mëparshëm të miratuar në vitin 2004.

Rastet e ngacmimit seksual janë të përcaktuara edhe në ligjin e ri të Kosovës për Barazi Gjinore të miratuar në vitin 2015.³⁹ Ligji i ri për Barazinë Gjinore ndalon ngacmimin seksual, duke e përcaktuar atë si "çdo formë sjelljeje të padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të një natyre seksuale, me qëllimin apo efektin e dhunimit të dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një ambient frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues⁴⁰". Në përputhje me ligjin kundër diskriminimit viktimizimi është gjithashtu i ndaluar në kuadër të ligjit për barazi gjinore dhe nuk lejohet asnjë pasojë negative për paditësin, nëse raportohen rastet e ngacmimit seksual.⁴¹

Masat ndëshkuese të parapara me Ligjin për Barazi Gjinore janë të ulëta duke filluar nga 300 € deri në një maksimum 900 €, dhe të gjitha gjobat e mbledhura parashihen që të transferohen në buxhetin e Kosovës. Ligji është kritikuar për mungesë qartësie në lidhje me aktet e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të raportuar dhe sanksionuar nga gjykata kompetente.⁴² Ligji nuk përcakton në mënyrë specifike procedurat kundërvajtëse, duke mbetur si një kërcënim serioz në zbatimin e ligjit. Procedurat e parashikuara për të raportuar çdo shkelje të mbuluar me ligj, mbeten të paqarta dhe në krahasim me Ligjin Kundër Diskriminimit nuk kanë qartësi. Këto procedura duhet të përpunohen dhe të shpjegohen në bazë të udhëzimeve administrative të parashikuara për t'u miratuar me Ligjin për Barazi Gjinore.⁴³

Monitorimi i mëparshëm nuk ka identifikuar asnjë rast në praktikën administrative apo ligjore të punëdhënësit ose të autorëve në organet publike që janë lëshuar gjoba për ngacmimin seksual

³⁸ Kosova miratoi ligjin e parë kundër diskriminimit në vitin 2004, që përfshinte edhe përkufizimin e ndërrimit të barrës së provës në rastet e diskriminimit në përputhje me kërkesat e Direktivave të BE-së. Shih ish versionin e ligjit në nr 2004.03, Ligjin Kundër Diskriminimit.

Në dispozicion në www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_3_en.pdf

³⁹ Shiko Ligjin e Kosovës për Barazi Gjinore, Ligji Nr. 05/L-020. Në dispozicion në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>.

⁴⁰ Ligji i Kosovës për Barazi Gjinore, Neni 3, paragrafi 1.12.

⁴¹ Ligji për Barazi Gjinore, Neni 3, paragrafi 1.19.

⁴² Supra note në Raportin e Rrjetit të Grave të Kosovës 19, 2016. Në dispozicion në <http://www.womensnetwork.org/documents/20160223185243349.pdf>

⁴³ Neni 24, i Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore, Nr.05/L-020. Në dispozicion në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>

në përputhje me kërkesat e Ligjit Kundër Diskriminimit dhe as Ligjit për Barazi Gjinore⁴⁴. Në përgjithësi, raportimi i rasteve të ngacmimit seksual mbetet shumë i ulët. Për më tepër, monitorimi i Artpolis-it nuk ka gjetur nga studentët ndonjë rast të raportuar në përputhje me kërkesat e ligjeve të përmendura më lart.

Procedurat penale që lidhen me rastet e ngacmimeve seksuale

Kodi i ri Penal i Kosovës i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013, nuk ofron një përkufizim të veçantë të ngacmimit seksual, por megjithatë përmbledh një numër të definicioneve nën disa nene të ndryshme. Deri në vitin 2014, kishte vetëm tre raste të raportuara, të iniciuara nga prokurorët publikë që kërkuan masa ndëshkuese për rastet që lidheshin me ngacmimin seksual⁴⁵. Studentët kanë pohuar gjithashtu se kanë hasur në vështirësi në raportimin e rasteve të ngacmimit seksual në Policinë e Kosovës për shkak të mungesës së një përkufizimi të caktuar të ngacmimit seksual brenda Kodit Penal të Kosovës.⁴⁶

Kodi Penal i Kosovës në bazë të nenit 186, ofron një përkufizim të përgjithshëm të ngacmimit, jo specifikisht për ngacmim seksual. Në përgjithësi, aktet e ngacmimit seksual janë të referuara dhe bien nën procedurat e krijuara sipas Ligjit Kundër Diskriminimit dhe Ligjit për Barazi Gjinore. Vetëm në rastet e akteve seksuale, nga persona që keqpërdorin pozitën ose autoritetin e tyre duke keqpërdorur kontrollin e tij ose të saj mbi rrethanat edukative të një personi tjetër, vepron kundër integritetit seksual të një personi, dënohet nga një deri në pesë vjet burgim. Aktet seksuale definohej si penetrim sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit⁴⁷. Përveç kësaj, abuzimi i autoritetit ose pozitës, duke përfshirë edhe rrethanat edukative të personit tjetër, mund të ndodhë edhe kur nënshtrohet një person tjetër për të kryer akt seksual dhe prekës⁴⁸. Në këto raste, nëse një

⁴⁴ Shiko, Norma, *Hulumtimi dhe Monitorimi i implementimit të Ligjit për Barazi Gjinore*, Prishtinë: Norma, 2011, fq. 18. Gjithashtu, shih Luljeta Demolli për Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), *Perceptimet e Shërbyesve Civil në lidhje me Ngacmimin Seksual në vendin e punës*, Prishtinë: QKSGJ, 2010, fq. 10. Cituar në raportin e Rrjetit të Grave të Kosovës, *Ngacmimi Seksual në Kosovë*, 2016. Në dispozicion në <http://www.womensnetwork.org/documents/20160223185243349.pdf>

⁴⁵ Shih raportin e Rrjetit të Grave të Kosovës, *Ngacmimi Seksual në Kosovë*, 2016. Në dispozicion në <http://www.womensnetwork.org/documents/20160223185243349.pdf>

⁴⁶ Intervistat e Artpolis-it me student femra, Qershor-Dhjetor 2016.

⁴⁷ Neni 228, paragrafi 3 definon aktin seksual si "... penetrim sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit." Kodi Penal i Kosovës, në dispozicion në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

⁴⁸ Neni 228, definon "Nënshtrimi i një personi tjetër për të kryer akt seksual, si "... kryerja e aktit seksual mbi personin tjetër nga kryerësi, ose nxitja e një personi tjetër të kryejë akt seksual mbi kryerësin ose një personi të tretë ose çytja e një personi të tretë për kryerjen e aktit seksual në një person tjetër; ose termi prekja si "... çdo kontakt direkt ose indirekt, ku nuk ka penetrim, midis trupit të personit me ndonjë pjesë të trupit të një personi tjetër, ose me një objekt," paragrafi 4 dhe 6. Kodi Penal i Kosovës, në dispozicion në <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

person abuzon pozicionin e tij apo të saj dhe e prek personin tjetër me qëllim seksual, personi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet⁴⁹. Në vetëm këto rrethana, veprat penale kundër integritetit seksual të një personi duhet të ndiqen penalisht.

